

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
MID DISTRIBUTION SH.P.K

Ne baze te ligjit nr. 9901, date 14 Prill 2008 “ Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare”, me vullnetin e lire dhe te plote, i cili shprehet me nenshkrimin e statutit te Shoqerise te re te themeluar nga ortaket si vijon :

1. Z. **MASSIMILIANO STUMPO**, lindur ne Cosenza (CS), Itali, me 26/04/1977, banues ne Rrugen dei Mille 35, 87100 Cosenza, (CS), Itali , identifikuar me pashaporte italiane nr. YB4473686, leshuar nga Ministria e Puneve te Jashtme, Itali, ne date 18/04/2019, e vlefshme deri ne date 17/04/2029, me zotesi te plote juridike per te kuptuar dhe vepruar :

Ortaket hartojne kete statut si me poshte vijon:

Neni 1
Emertimi i shoqerise

Emri i shoqerise eshte “**MID DISTRIBUTION SHPK**” . Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar, do te regjistrohet ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB) me emrin “**MID DISTRIBUTION SHPK**” (ne vijim “Shoqeria”)

Neni 2
Selia e shoqerise

Selia e Shoqerise eshte ne Rrugen “Xhoxhi Martini”, Nd.30, njesia bashkiake nr. 2, Tirane,Shqiperi

Neni 3
Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise fillon nga momenti i regjistrimit te saj prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB)dhe eshte me afat te pacaktuar.

Shoqeria e fiton personalitetin juridik nga momenti i Regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB) Tirane.



Neni 4 **Objekti i shoqerise**

Shoqeria ka per objekt ofrimin e sherbimeve si me poshte vijon:

Prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice, import-export, te produkteve jo ushqimore te ndryshme, ne vecanti te mallrave te tilla si:

- Makina qepese, tekstile dhe veshje;
- Elektroshtepiake te ndryshme, dysheke, mobilje si dhe artikujve te ndryshem per shtepine;
- Televizore si dhe pajisje te tjera regjistrimi audio dhe video, radio, pajisje optike dhe fotografike, sisteme te perpunimit te te dhenave, pajisje elektronike, komjuterat, produkte dhe aksesore te lidhura me to;
- Materiale elektrike, sisteme ndricuese, pajisje dhe sistem per prodhimin e energjise elektrike, sisteme ngrohje, ftohje, avullimi;
- Makineri dhe pajisje bujqesore;
- Mobilje , pajisje dhe artikuj zyre dhe sportive;
- Sherbime per instalimin, montimin, riparimin, mirembajtjen, dhenien me qira dhe asistence teknike te ketyre produkteve;
- Sherbime ndermjetesimi dhe perfaqesimi tek te gjitha sektoret e produkteve te permendura ne Shqiperi dhe jashte saj;
- Sherbime te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, blerje, shitje, shkembime, garanci, sherbime financiare te cilat jane te nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise;
- Lidhje e kontratave te qerases, Franchising, Know-how, Marka tregtare, Patenta e Liceca;
- Pjesemarrje ne konsorcium, mbledhje me kompani dhe sipermarrje te njejta vendase te huaja

Neni 5 **Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali i Shoqerise eshte i barabarte me ALL 10.000 (dhjete mije leke). Kapitali themeltar eshte i perbere nga 1 (nje) kuote e cila i perket Ortakut te meposhtem;

- Z. Massimiliano Stumpo, zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme prej ALL 10.000 (dhjete mije leke) qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise;



Kapitali fillestar i Shoqerise mund te rritet dhe eshte totalisht i paguar dhe i nenshkruar nga ortakët.

5.2 Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, nga pasuri te luajtshme ose te paluajtshme dhe nga pasuri te tjera te dhena ose qe do te jepen te cilat jane te domosdoshme per ushtrimin e aktivitetit te Shoqerise.

5.3 Kuotat e kapitalit derdhen nga ortaku ne Banke, ne llogarine bankare te Shoqerise

5.4 Ortaket kane te drejte te terheqin fondet e depozituara si kapital themeltar te shoqerise, ne rast se Shoqeria nuk Regjistrohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, brenda 6 (muaj) nga data e depozitimit te fondeve.

Neni 6 Trasferimi i kapitalit

6.1 Transferimi I kuotave eshte i vlefshem si me akt midis te gjalleve si dhe me trashegimi ndaj ortakëve te Shoqerise, vetem ne rast se rezulton se jane respektuar dispozitat e ketij neni.

6.2 Ne rast transferimi te kuotave midis te gjalleve me akt, ortakëve i takon e drejta e parablerjes. Ortaku transferues me pare duhet te beje nje oferte ortakëve te tjere me leter rekomande, ku percakton çmimin e kerkuar per shitjen e kuotave te tij. Ne kete rast secili nga ortakët me proporcion me pjesemarrjen ne kapitalin themeltar ka te drejten e parablerjes.

6.3 ne rast mosmarreshjesh per çmimin e kerkuar, ky i fundit do te percaktohet nga nje ekspert kontabel i cili miratohet me shumice te thjeshte nga Asambleja e Ortakëve, i cili do te percaktoje çmimin e shitjes duke u bazuar ne vleren reale te kuotave.

6.4 Ne rast mosmarreshje mbi emerimin e ekspertit kontabel, ky i fundit me shpenzimet e seciles pale, do te zgjidhet nga gjykata ku ka seline shoqeria dhe me kerkese te pales te interesuar.

6.5 Eksperti duhet te kryeje vleresimet sipas kritereve dhe menyrave te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

6.6 Pas vleresimit te kuotave nga ana e ekspertit, shitesi por edhe bleresi kane te drejte te terhiqen, perkatesisht nga shitja dhe blerja dhe shpenzimet e ekspertit do te jene ne ngarkim te personit qe terhiqet.

6.7 E drejta e parablerjes qe nuk eshte ushtruar nga ana e njerit prej ortakëve i kalon ortakëve te tjere, gjithmone ne perputhje me kuotat e tyre ne kapitalin themeltar.



6.8 Ortaku shites i kuotave duhet ti trasferoje keto te fundit me akt te shkruar ortakeve bleres brenda 3 muajve nga marrja e komunikimit dhe ne rast te vleresimit te bere nga eksperti kontabel brenda afatit prej 60 dite nga dita e vleresimit.

6.9 E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet brenda nje periudhe tre mujore nga data e komunikimit te ofertes ose brenda 60 diteve nga data e fiksimit te çmimit nga ana e ekspertit kontabel qe eshte emeruar. Pasi kane kaluar afatet e mesiperme, shitesi ka te drejte te trasferoje tek te tretet kuotat e tij.

6.10 Transferimi i kuotave per shkak trashegimie ndaj trashegimtareve te te ndjerit eshte i kufizuar me dhenien e miratimit te ortakeve te mbledhur ne asamblene e pergjitheshme. Ne rast kundershtimi te ortakeve per transferimin e kuotave drejt trashegimtareve te te ndjerit, çmimi i shitjes do te percaktohet sipas procedurave per transferimin me akt midis te gjalleve si me siper.

Neni 7

Fitimet e shoqerise i takojne ortakeve te saj. Asambleja sipas ligjit vendos per ndarjen ose riqarkullimin e tyre, duke percaktuar edhe menytrat.

Neni 8

Shoqeria do te perdore dhe disponoje pasurine e saj te akumuluar. Ajo mund te bleje dhe shfrytezoje te drejta te tjera, material ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet te akumuluar, tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria gezon te drejta sikunder çdo person tjetër juridik, shqiptar ose I huaj, sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 9

Shoqeria, vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejtat e detyrimet vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket mbartin rrezikun e veprimtarise te shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

Neni 10 **Drejtimi i Shoqerise**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.



Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- 9) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "9" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete,

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 11

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese



apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

Neni 12 Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 13 Administrimi

Asambleja e pergjithshme emerohet nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertesitjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i here ne kundersizim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.



Administratori i vetem i shoqerise eshte :

1. Z. **MASSIMILIANO STUMPO**, lindur ne Cosenza (CS), Itali, me 26/04/1977, banues ne Rruget dei Mille 35, 87100 Cosenza, (CS), Itali , identifikuar me pashaporte italiane nr. YB4473686, leshuar nga Ministria e Puneve te Jashtme, Itali, ne date 18/04/2019, e vlefshme deri ne date 17/04/2029, me zotesi te plote juridike per te kuptuar dhe vepruar :

I cili ushtron te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme konform ligjit te Republikes te Shqiperise.

Neni 14 **Kompetencat e administratoreve**

Administratori kryen detyrat e percaktuara nga ortaket e shoqerise ne kete statut dhe te gjitha ato detyra te parashikuara dhe te rregulluara me ligj. Nder keto perfshihen detyrat e listuara me poshte:

- a) Te veproje dhe te nenshkruaje ne emer te shoqerise
- b) Te hartoje rregulloren e brendshme te shoqerise dhe nje plan biznesi per vitin financiar, qe do te miratohet ne asamblene e pergjithshme.
- c) Te marre vendime lidhur me kredite qe do te merren dhe dhenien e garancive
- d) Te perpunoje dhe te paraqese per miratimin ne asamblene e pergjithshme raporte per ecurine e aktivitetit te shoqerise dhe te bilancit te mbylljes se aktivitetit financiar te vitit paraardhes , sipas asaj qe parashikohet me ligj.
- e) Te mbaje ne rregull regjistrin e vendimeve te asamblese te pergjithshme.
- f) Administratori (apo administratoret ne rast se do te emerohet ndonje tjeter ne vijim) eshte pergjegjes kundrejt shoqerise dhe te treteve per shkeljen e ligjit apo te normave te statutit qe mund te ndodhin gjate ecurise te aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar
- g) Te kryeje te gjitha aktivitetet e administrimit te aktivitetit tregtar te shoqerise, duke aplikuar politika tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme.
- h) Te perfaqesoje shoqerine tregtare.
- i) Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;



- j) Te kryeje regjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- k) Te kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
- l) Te raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- m) Pranimet ne pune, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore per vartesis, miratimin e kerkesave per largim nga puna;
- n) Te emeruje financiere e konsulente per problemet e shoqerise. Financieri nxjerr rregullisht indikatoret financiare 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.
- o) Te mire administroje shoqerine;
- p) Te lidhe marreveshje me te trete ne kufijte e objektivi te aktivitetit te shoqerise dhe te kompetencave te percaktuara nga ortaket;
- q) Te zbatoje rregulloren e brendshme te shoqerise;
- r) Te jete pergjegjes per demet e shkaktuara shoqerise nga veprimet e tij;
- s) Te shperblehet per punen qe kryhet sipas marreveshjes me ortaket themelues;
- t) Te informohet dhe te beje propozime per cfaredolloj gjeje qe e vlereson si te rendesishme per shoqerine;
- u) Te kryeje te gjitha veprimet bankare ne lidhje me llogarite e shoqerise;
- v) Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, sipas dispozitave te percaktuara ne nenet 12 dhe 13 t ketij statuti dhe te ligjit aty ku nuk parashikohet shprehimisht ne statut.

Neni 15 **Te drejtat e shoqerise**

Shoqeria ka te drejte:

- a) te kryeje veprimtari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise;
- b) te siguroje pasurine e vet;
- c) te marre kredi ne lekedhe ne valute nga bankat vendase ose te huaja ne baze te rregullave ligjore;



- 9) te perfitoje nga favoret qe i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera;
- d) te investoje kudo ne Shqiperi, me te ardhura qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj;
- e) te punesoje punetore, vendas ose te huaj;
- f) te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj;

Neni 16 **Detyrat e shoqerise**

Shoqeria ka per detyre :

- a) Te siguroje kapitalin e shoqerise ne formen dhe kohen e duhur;
- b) Te jape garanci per sherbimet qe kryhen shoqeria;
- c) Te siguroje punonjesit e saj;
- d) Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit , si dhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
- e) Te pajiset me leje/autorizime te mundshme, nese kerkohet nga ligji, per te zbatuar objektin e veprimtarise te saj;
- f) Te respektoje standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj;

Neni 17 **Marredheniet ekonomiko – financiare te shoqerise**

E gjithe veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise te saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

Neni 18

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni financiar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 mars te cdo viti nxirret bilanci vjetor i shoqerise.

Neni 19

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.



Neni 20

Shoqëria mban llogarinë e saj në banke. Llogaritë mbahen në Lekë dhe/ose në Euro dhe pasqyrohen në librat kontabel përkatës.

Neni 21

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar, Shoqëria, pasi ben zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, le menjëherë 5% të fitimit, me të cilin krijohet fondi "Rezervë e domosdoshme", derisa ky fond të arrijë masën 10% të kapitalit themeltar.

Neni 22

Disposita të veçanta

Shoqëria ka vullnet të saj me përmasa të zakonshme, të realizuar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi.

Neni 23

Shndërrimi

Shndërrimi i shoqërisë në shoqëri të tipeve të tjera, mund të bëhet me vendim të ortakeve themelues sipas mënyrave të parashikuara me ligj.

Neni 24

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë, për shkak të parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 dhe për arsye të mëposhtes:

- a) kur mbaron kohe zgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;
- f) humja e kapitalit të shoqërisë



Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore duke u percaktuar dhe detyrat. Administratori dhe likuidatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise te shoqerise deri sa ajo tu dorezohet personave perkates fizike e juridike, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet qe ka shoqeria ndaj personave te trete.

Ne rast se fondet e disponueshem, rezultojne te pamjaftueshem, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund ti kerkoje ortakeve themelues te shoqerise qe te derdhe teresisht kuotat qe u takojne.

Neni 25 **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 26 **Mosmarreveshjet**


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 27

Ky statut perpilohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe, te perkthyer edhe ne gjuhen italiane, te nenshkruara rregullisht nga ortaket.



ORTAKET
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
MID DISTRIBUTION SHPK

MASSIMILIANO STUMPO
MASSIMILIANO STUMPO


Tirane me 25/09/2024